



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Qershor 2022

Nr: 171

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE”, NDAJ KRYETARIT TË BASHKISË RROGOZHINË Z. EDISON MEMOLLA, ZËVENDËSKRYEMINISTRIT, NJËKOHËSISHT MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE Z. ARBEN AHMETAJ DHE DEPUTETIT Z. ETJEN XHAFAJ, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 1 Qershor 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

**Kërkues:** Organizata “Qendresa Qytetare”

**Objekti:** Kryerja e aktiviteteve me karakter publik në kundërshtim me nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

**Ndaj:** Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla;  
Zëvendëskryeministrin, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj;  
Deputetit z. Etjen Xhafaj

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, vendimi nr. 9, datë



Data: 1 Qershor 2022  
Nr. 171

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj kryetarit të bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla, Zëvendëskryeministrin, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave z. Arben Ahmetaj dhe deputetit z. Etjen Xhafaj, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe llogjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

## V Ë R E N :

### I. Vlerësimi paraprak

- 1- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 06.03.2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar nga Organizata “Qendresa Qytetare”, denoncimi me nr. 3718 ID unik i gjeneruar nga sistemi, ora 12:48 PM, ku pretendohet se, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në datë 04.03.2022, z. Edison Memolla, kandidat i Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar të bashkisë Rrogzhinë, i shoqëruar nga Zv. Kryeministri dhe njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, deputeti i zonës z. Etjen Xhafaj dhe disa banorë të zonës, kanë inspektuar shkollën “Qamil Gjuzi”, e cila është në proces rindërtimi.
- 2- Sipas denoncuesit, *“Në datë 04.03.2022, në Rrogzhinë, kandidati i Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar të bashkisë Rrogzhinë, z. Edison Memolla, i shoqëruar nga zv. Kryeministri njëkohësisht dhe Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, me pjesëmarrjen e deputetit të zonës dhe disa banorë të zonës, inspektuan shkollën “Qamil Gjuzi” që është në proces rindërtimi. Gjatë këtij takimi, siç vërehet nga provat, z. Memolla dhe z. Arben Ahmetaj, në këtë takim kanë promovuar investime vendore në atë zonë duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore”. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore në referim të vendimit nr. 2, pika 2, datë 22.01.2022 i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur nenin 91, pasi nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve, burime (asete) të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor; në aktivitete të klasifikuara si “Veprimtari e ndaluar për t’u promovuar”, në referim edhe të nenit 3, pika 1.1/d, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Gjithashtu në referim të nenit 6, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2022, “...Punonjësit e administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore, publike, me qëllim favorizimin e një*

partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”. Në këtë rast, Ahmetaj, siç shihet nga pamjet është pjesëmarrës në një veprimtari me karakter publik.

Gjatë këtij takimi, siç vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të z. Memolla, shprehet mbi veprimtarinë: “Inspektim me zv. Kryeministrin z. Arben Ahmetaj dhe deputetin z. Etjen Xhafaj në shkollën “Qamil Gjuzi” që është në proces rindërtimi”. Ndër të tjera, në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ky takim nuk rezultoi të jetë raportuar në referim të parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.

Bashkëlidhur denoncimit janë dërguar edhe provat forografike dhe link si më poshtë:

1- <https://www.facebook.com/edison.memolla.1/posts/348167980556781>

2- <https://www.facebook.com/etjen.Xhafaj.al/posts/340348584771924>

3- <https://www.facebook.com/arben.ahmetaj.al/posts/511709760319711>

3- Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat, si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

4- Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

5- Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

6- Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, z. Edison Memolla, zv. Kryeministrit, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj dhe deputetit z. Etjen Xhafaj, ndaj të cilëve atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

## II. Rrethanat e faktit

- 7- Në denoncimin e raportuar pretendohet se, kandidati i Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar të bashkisë Rrogozhinë, z. Edison Memolla dhe zv. Kryeministri, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kanë promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator.
- 8- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1634 prot., datë 07.03.2022, me lëndë “Kërkesë për informacion” i ka kërkuar zv. Kryeministrit, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla, Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Etjen Xhafaj dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, informacion sqarues në lidhje me pretendimet e ngritura nga pala denoncuese dhe vendimmarrjen e tyre.
- 9- Nëpërmjet shkresës nr. 1431/1 prot., datë 10.03.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1634/1 prot., datë 11.03.2022, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj pretendon se: Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave ka marrë pjesë në këtë event në cilësinë e të ftuarit, në kuadër të procesit të rindërtimit.
- 10- Nëpërmjet shkresës nr. 1793 prot., datë 16.03.2022, të administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Deputeti i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Etjen Xhafaj pretendon se:
  - Në cilësinë e deputetit të qarkut Tiranë, përfaqëson komunitetin e qytetarëve të Njësisë të Qeverisjes Vendore Bashkia Kavajë dhe Bashkia Rrogozhinë. Si deputet i zonës, pjesën kryesore të agjendës së tij e merr angazhimi personal për rritjen e mirëqenies dhe shërbesave ndaj qytetarëve të këtyre bashkive. Në përmbushje të misionit të tij si deputet, i është bashkuar z. Memolla dhe z. Ahmetaj gjatë inspektimit të punimeve që po realizohen në shkollën 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”.
  - Fondet për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi” janë miratuar me anë të vendimit nr. 360, datë 16.06.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të 2 objekteve arsimore në bashkinë Rrogozhinë dhe caktimin e bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese” dhe fondet publike për këtë investim nuk janë miratuar rishtazi apo posaçërisht, sa parashikuar në nenin 3, pika 1.1, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

- Në nenin 3, pika 1.1 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikohet se: *“Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”*. Fondet për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi” nuk janë miratuar pas Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Repulikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjeshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, po me anë të vendimit nr. 360, datë 16.06.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të 2 objekteve arsimore në bashkinë Rrogozhinë dhe caktimin e bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese” dhe nuk bien në kundërshtim me vendimin nr. 9/2020 të KQZ-së.
- Gjatë angazhimit të tij në zgjedhjet e pjeshme në bashkinë Rrogozhinë, është kujdesur që aktivitetet ku ka qenë pjesëmarrës të ishin në pajtueshmëri me nenet 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, duke i kërkuar bashkisë Rrogozhinë raportimin e aktiviteteve, sipas parashikimeve të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Bashkia Rrogozhinë ka vendosur në dispozicion shkresën nr. 296/2 prot., datë 01.02.2022, me anë të së cilës është njoftuar KQZ-së lista e aktiviteteve me karakter publik të Bashkisë Rrogozhinë, ku rezulton i raportuar edhe aktiviteti “Inspektimi i fillimit të punimeve të shkollës “Qamil Gjuzi”.

11- Nëpërmjet shkresës nr. 914/1 prot., datë 10.03.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1739 prot., datë 15.03.2022, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla, pretendon se:

- Inspektimi i shkollës 9 vjeçare “Qamil Gjuzi” nuk është një veprimtari e ndaluar sipas vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, pasi sipas nenit 3, pika 1.1. të vendimit parashikohet se, veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
- Fondet për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi” nuk janë bërë rishtaz, pas datës së dekretit të Presidentit, por me anë të vendimit nr. 360, datë 16.06.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të 2 objekteve arsimore në

bashkinë Rrogozhinë dhe caktimin e bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese”, prandaj veprimtaria në fjalë nuk bën pjesë në veprimtarinë e ndaluara.

- Bashkia Rrogozhinë ka raportuar në KQZ “Inspektimin e fillimit të punimeve të shkollës “Qamil Gjuzi”, me anë të shkresës nr. 296/2 prot., datë 01.02.2022.

12- Me vendimin nr. 158, datë 05.06.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, për shkëlqe të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Edison Memolla, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Rrogozhinë, z. Etjen Xhafaj, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë, sepse hetimi administrativ rezultonte ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

13- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2418 prot., datë 17.05.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 19 Maj 2022, ora 11:00, me palë Organizata “Qëndresa Qytetare”, z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Edison Memolla, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Rrogozhinë dhe z. Etjen Xhafaj, deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

14- Në seancë dëgjimore të datës 19 Maj 2022, u paraqitën palët në proces, organizata “Qëndresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti e autorizuar nëpërmjet autorizimit të datës 01.04.2022, Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave me përfaqësues zj. Solora Llatja autorizuar me shkresën nr. 2876/1 të paraqitur në seancë, Bashkia Rrogozhinë e përfaqësuar nga z. Helidon Plaku nëpërmjet autorizimit nr. 2144/1 datë 19.05.2022 të paraqitur gjatë seancës dëgjimore.

15- Gjatë pretendimeve të saj, **përfaqësuesi i organizatës “Qëndresa Qytetare” zj. Kurti** u shpreh se: Në datën 04.02.2022, është zhvilluar një takim i kandidatit të Partisë Socialiste për kryetar të bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave z. Arben Ahmetaj dhe Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Etjen Xhafaj. Në këtë takim pjesëmarrësit e këtij takimi kanë inspektuar shkollën “Qamil Gjuzi”, shkollë në proces rindërtimi. Gjatë këtij takimi janë promovuar investime vendore në atë zonë, si dhe investime të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore. Lidhur me deklaratimet e palëve, gjithashtu edhe në shkresën e kabinetit të zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit, njihemi me faktin se z. Arben Ahmetaj, në këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e të ftuarit në kuadër të procesit të rindërtimit, si dhe në cilësinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave. Neni 6, pika 3 e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator sanksion se punonjësit të administratës i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje. Në këtë

rast, z. Arben Ahmetaj, si një nga organet e larta të administratës shtetërore, ka marrë pjesë në një aktivitet me karakter publik, në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore. Rrjedhimisht, sipas organizatës “Qendresa Qytetare”, prezanca e z. Ahmetaj implikon favorizimin e kandidatit në zgjedhje.

- 16- Lidhur me takimin e zhvilluar, pretendohet se është njoftuar pranë KQZ-së me shkresën nr. 296/2 prot., datë. 01.02.2022. Nga kërkimet e bëra në faqen e raportimeve të KQZ-së nuk është raportuar ky aktivitet, duke mosrespektuar parashikimet e nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Bazuar në këto, organizata “Qendresa Qytetare” pretendon se palët nuk kane respektuar parashikimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe kërkohet marrja e masave administrative.”
- 17- **Përfaqësuesi i Bashkisë Rrogozhinë, z. Plaku** konfirmoi se takimi i kryer ka qenë konform rregullave ligjore, investimet për shkollën “Qamil Gjuzi” datojnë që më 30.06.2021, ndërsa përsa i përket raportimit të inspektimit ai është kryer nëpërmjet shkresë 296/2 prot. datë 01.02.2022. Inspektimi nuk është kryer për arsye të promovimit të fushatës zgjedhore por vetëm për zbatim të planit të punës të Bashkisë Rrogozhinë. Për sa më sipër, pretendimet e palës denoncuese nuk janë të bazuara në ligj.
- 18- Përfaqësuesi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave zj. Solora Llatja pretendoi se, Ministri ka qenë në cilësinë e të ftuarit për një program rindërtimi i cili ka dy vite që ka nisur. Financimi nuk ka qenë i katër muajve të fundit ashtu sikurse kërkon dhe vendimi nr. 9 datë 24.12.2020. Përsa u përket pretendimeve të denoncuesit së janë përdorur burimet publike nëpërmjet përdorimit të mjeteve të institucioneve, kërkohet nga pala denoncuese prova për përdorimin e mjeteve nga ana e z. Ahmetaj.
- 19- Përfaqësuesi i organizatës “Qendresa Qytetare” zj. Kurti, pretendoi se përdorimi i mjeteve nga ana e z. Ahmetaj vërtetohet thjesht me faktin që në përgjigjen shkresore zyrtare, ai ka pranuar pjesëmarrjen e tij në këtë aktivitet dhe logjikisht ka përdorur mjetet e institucionit dhe jo ato private. Z. Ahmetaj në axhendën e tij të asaj dite, ka pasur edhe takime të tjera elektorale të cilat janë publikuar në faqen e tij zyrtare”Facebook”.
- 20- Përfaqësuesi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave zj. \_\_\_\_\_ në kundërpërgjigje të përfaqësuesit të organizatës “Qendresa Qytetare” deklaroi se vizitat e z. Ahmetaj gjatë asaj dite kanë qenë në kuadrin si ish deputet i asaj zone. Përsa u përket pretendimeve se është kryer promovim i investimeve në mbështetje të një kandidati, nga shqyrtimi i gjithë materialeve të publikuara në media, z. Ahmetaj në asnjë moment nuk ka dalë në mbështetje të kandidatit, por thjesht e ka përqëndruar komunikimin e tij në investim e kryer në shkollën “Qamil Gjuzi”.
- 21- Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve, në përfundim kërkoi nga palët në rast se ka kërkesa shtesë për marrje dokumentacioni dhe asnjëri nga palët nuk kërkoi. Në pretendimet përfundimtare, pas shpalljes së mbylljes së hetimit administrativ, denoncuesi kërkoi pranimin e kërkesave dhe marrjen e masave për denoncuesit, ndërsa bashkia Rrogozhinë dhe përfaqësuesi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave kërkuan mospranimin e kërkesëpadisë pasi takimi është kryer konform rregullimeve ligjore.

### III. Analiza ligjore

- 22- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në ambientet e shkollës “Qamil Gjuzi” për të inspektuar punimet përbën një veprimtari me karakter publik, pasi ka pasur pjesëmarrjen të banorëve të zonës dhe punonjësve.
- 23- Neni 92, pika 1 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, parashikon se *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Referuar ndërfaqes së raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve rezultoi se Bashkia Rrogozhinë, si institucioni që organizon aktivitetin publik, nuk e ka raportuar këtë aktivitet. Bashkia Rrogozhinë pretendon se ky aktivitet i është njoftuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 296/2 prot., datë 01.02.2022, protokolluar pranë institucionit tonë me shkresën nr. 474 prot., datë 03.02.2022. Në këtë shkresë, Bashkia Rrogozhinë ka listuar veprimtaritë me karakter publik që bashkia ka pasur të planifikuara për të kryer gjatë periudhës që kërkohej raportim pranë KQZ-së. Neni 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator parashikon se: **“Struktura përkatëse e teknologjisë së informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mundëson akses të personalizuar në këtë ndërfaqe për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, me qëllim që të hedhin të dhënat për institucionin që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë”**. Kërkesat ligjore janë të qarta për mënyrën e raportimit dhe përmbajtjen e tij. Për sa më sipër, vlerësojmë se aktiviteti publik i kryer nga Bashkia Rrogozhinë, nuk mund të konsiderohet i raportuar për shkak se nuk përmbush kërkesat ligjore si i tillë.*
- 24- Neni 3, pika 1, nënndarja 1.1, shkronja “d”, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikon se *“Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore”*.
- 25- Neni 3, pika 1, nënndarja 1.1, e kufizon fushën e veprimit në ato veprimtari publike për të cilat janë **vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion**, apo janë **transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Në mënyrë që të kemi shkelje të shkronjës “d” ... *“mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të*



*fatkeqësive natyrore*”, duhet që fondet e përdorura për mbështetjen promovimin e këtyre objekteve të ishin vendosur **rishtazi apo posaçërisht në dispozicion** dhe të ishin transferuar **jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Këto janë kushte komulative të përcaktuara nga neni 3, dhe nuk mund të lexohen të ndara nga njëra-tjetra.

26- Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprimtari me fonde të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar, pasi vendimi nr. 360, datë 16.06.2021, i Këshillit të Ministrave është miratuar 7 (shtatë) muaj para dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, nga Presidenti. Vlen të theksohet se miratimi i këtij vendimi është në përmbushje të zbatimit në vazhdimësi të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe ka dalë në bazë dhe për zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

27- Denoncuesi pretendon se nga ana e z. Ahmetaj dhe z. Xhafaj, kemi shkelje të nenit 6, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator ku parashikohet se, *“Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”*.

28- Referuar të denoncuarit, deputetit z. Etjen Xhafa, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 2 e vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për këtë arsye nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ.

29- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson të rëndësishme të sqarojë se z. Memolla **në funksionin e Kryetarit të Bashkisë** dhe jo atë të kandidatit për kryetar bashkie, si dhe z. Ahmetaj **në funksionin e Ministrër i Shtetit për Rindërtim dhe Programin e Reformave** dhe jo në atë të Zëvendëskryeministrit, **si autoritet përgjegjës** për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ndër të tjerash edhe **ministrin përgjegjës** në fushën e përgjegjësisë të të cilit, përfshihet përballimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore dhe fatkeqësi të tjera, si **dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore**. Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” ka përcaktuar në nenin 12, shkronja “c” dhe “d”, Në aktet e tjera të dala në funksion tij, pjesë e detyrave funksionale në shërbim të procesit të rindërtimit të kryetareve të bashkisë, administratorëve të njësive bashkiake dhe ministrit përgjegjës është monitorimi, vizitat në terren dhe inspektimi i standardeve të ndërtimit, në mënyrë që të bëhet përdorimi eficient i burimeve shtetërore.

Kryerja e inspektimit gjatë periudhës zgjedhore nuk e kategorizon këtë takim si takim elektoral pasi ministri dhe kryetari kanë qenë duke kryer detyrat funksionale që u'a dikton fusha e pergjegjësive e përcaktuar me ligje të veçanta. Kryetarët e bashkive, që njëkohësisht kandidojnë në zgjedhjet vendore për të njëjtin pozicion, nuk heqin dorë nga detyra e tyre gjatë periudhës që ata janë kandidatë.

- 30- Për sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, kryerja e inspektimit të shkollës “Qamil Gjuzi”, nga z. Ahmetaj, z. Xhafaj dhe z. Memolla nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- 31- Referuar nenit 10, pika 1 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator ku parashikohet se: *“Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se Bashkia Rrogozhinë është në shkelje të nenit 92, pika 1, e Kodit Zgjedhor dhe të nenit 4, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.*

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” ‘n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.
2. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj deputetit z. Etjen Xhafaj, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
3. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 1 Qershor 2022

Nr. 171

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj kryetarit të bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla, Zëvendëskryeministrit, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave z. Arben Ahmetaj dhe deputetit z. Etjen Xhafaj, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”